



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr._____, Datë_____._____.2025

PËR
DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9780, DATË 16.7.2007, “PËR
INSPEKTIMIN DHE MBROJTJEN E TERRITORIT NGA NDËRTIMET E
KUNDËRLIGJSHME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja a), e nenit 3, shfuqizohet.
2. Shkronja b) e nenit 3, ndryshohet si më poshtë:
“b) Struktura Qendrore për Inspektimin – Inspektorati Qendror për Territorin, Mjedisin dhe Pyjet, e cila organizohet në nivel qendror dhe rajonal nëpërmjet mbulimit të territorit me drejtori rajonale dhe zyra vendore.”

Neni 2

Neni 4 shfuqizohet.

Neni 3

Neni 5 shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 8 bëhen kë to ndryshime:

1. Pika 4, e nenit 8, shfuqizohet.
2. Në pikat 1, 2, 3, 5, si dhe kudo në dispozitat e këtij ligji në të cilat përdoret togfjalëshi “Inspektorati Kombëtar i mbrojtjes së Territorit”, zëvendësohet me togfjalëshin “Struktura Qendrore për Inspektimin – Inspektorati Qendror për Territorin, Mjedisin dhe Pyjet.”

Neni 5

Në shkronjën a), të nenit 8/1, togfjalëshi “si dhe të inspektorateve vendore”, shfuqizohet.

Neni 6

Shkronja b), e Nenit 9 ndryshohet si më poshtë:

“b) nëpërmjet strukturave përgjegjëse në qendër, kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji, të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe të ligjit për kontrollin e disiplinimit të punimeve të ndërtimit nga struktura qendrore e inspektimit në nivel rajonal/zyrë vendore, dhe merr masa të cilat zbatohen menjëherë, sipas nenit 15 të këtij ligji dhe ligjeve të tjera specifike në fushën e planifikimit e zhvillimit të territorit”.

Neni 7

Në Nenin 9/1, bëhen ndryshimet si vijon:

1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Struktura Qendrore për Inspektimin – Inspektorati Qendror për Territorin, Mjedisin dhe Pyjet, përveç detyrave të tjera, të parashikuara në këtë ligj, ushtron kontrolle nëpërmjet inspektimit në nivel qendror dhe rajonal/zyrë vendore, dhe ka përgjegjësi duke marrë masat e mëposhtme:

a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe atë të disiplinimit të punimeve;

b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Për shkeljet e lejeve të ndërtimit në kompetencë të KKTU-së, vendos gjoba me propozim të Sekretariatit Teknik të KKTU-së, apo të strukturës përgjegjëse qendrore për inspektimin;

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit;

ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;

dh) nëpërmjet trupës inspektuese të strukturës qendrore rajonale/zyrë vendore, referon/përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

e) përgatit faturën e zhdëmtimit në ngarkim të subjektit kundërvajtës, për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme, e cila përbën titull ekzekutiv sipas ligjit;

ë) përgatit raporte periodike dhe ia paraqet Inspektorit të Përgjithshëm, sipas parashikimeve të bëra në Ligjin “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

f) për lejet e ndërtimit në kompetencë të KKTU-së, vendos masat sipas shkronjave “b”, “ç”, “d” dhe “dh” pasi bashkërendon procesin e kontrollit e të monitorimit me Sekretariatit Teknik të KKTU-së;

g) për të gjitha lejet e ndërtimit në proces zbatimi, të dhëna nga organet përgjegjëse për zhvillimin e territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit nëpërmjet drejtorive rajonale/zyrave vendore, për çdo leje ndërtimi, përcakton të paktën një inspektor, i cili do të jetë personi përgjegjës, që ka për detyrë të monitorojë dhe të kontrollojë periodikisht zbatimin e ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, gjatë gjithë procesit të zbatimit të punimeve deri në kolaudimin përfundimtar të ndërtimit.

Fjala “ndërtim/punim”, sipas këtij neni, përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që ndërtohen ose instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen nën dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe që i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit të inspektimit.

Gjithashtu konsiderohet punim/zhvillim/ndërtim i një objekti të ri, prishja e objektit, rikonstrukcioni i objektit, riparimi i objektit, infrastruktura tokësore e nëntokësore, si dhe prishja e objekteve që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

gj) ushtron të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj lejes së ndërtimit, të miratuar në kundërshtim me ligjin dhe/ose dokumentet e planifikimit në fuqi.

2. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve, përgjegjësitë e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, i ushtron edhe në koordinim me Prefektin e Qarkut, i cili është përgjegjës për:

a) bashkërendimin dhe koordinimin me njësitë e qeverisjes vendore në juridiksionin e qarkut, lidhur me kërkesat për inspektim dhe kontroll të ligjshmërisë në zbatim të këtij ligji, të cilat adresohen tek njësitë e vetëqeverisjes vendore apo paraqiten nga vetë ato;

b) bashkërendim dhe koordinim me Policinë Bashkiake për dhënien e asistencës dhe ndihmës për Inspektoratin Qendror për Territorin, Mjedisin dhe Pyjet gjatë ushtrimit të përgjegjësisë së saj, brenda juridiksionit të qarkut.

c) bashkërendim dhe koordinim me Policinë e Shtetit, e cila gjatë ushtrimit të përgjegjësisë së saj brenda juridiksionit të qarkut, kur konstaton paligjshmeri në territor, ka për detyrë të referojë rastin pranë Inspektoratit Qendror për Territorin, Mjedisin dhe Pyjet, për vijimin e mëtejshëm të procedurave ligjore, të mbështese dhe/ose asistojë strukturën inspektuese gjatë veprimtarisë së inspektimit, si dhe të zhvillojë veprime hetimore nëse shkelja e konstatuar përbën edhe veper penale.

3. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Inspektoratit Qendror të Territorit, Mjedisin dhe Pyjeve, përgjegjësitë e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, i ushtron edhe në bazë të kërkesës nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të KKTU-së, për lejet në kompetencë të KKTU-së”.

4. Në pikën 4, togfjalëshi “sipas shkronjës “b”, zëvendësohet me togfjalëshin “sipas shkronjës “gj”.

Neni 8

Në Nenin 9/2, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalia e dytë, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

“Në raste të tilla, Inspektoratit Qendror të Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve koordinohet me Prefektin Detar, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe koordinimin me njësitë e qeverisjes vendore në juridiksionin e qarkut, me synim evidentimin e ekzistencës së ndërtimeve të tilla, dhe përcjelljen e çështjes për kompetencë Inspektoratit Qendror të Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve”.

2. Në pikën 2, togfjalëshi “njërën nga”, shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 11, togfjalëshi “në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore”, ndryshohet me togfjalëshin “e Inspektoratit Qendror për Territorin, Mjedisin dhe Pyjet”.

Neni 10

Në nenin 12, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1, e nenit 12, ndryshohet si më poshtë:

“1. Për ushtrimin e përgjegjësiave dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve kryen inspektime me një grup inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se tre inspektorë. Për kontrollin e lejeve të ndërtimit në kompetencë të KKTU-së, strukturës i shtohen edhe dy persona përgjegjës me rol mbështetës, nga drejtoria e monitorimit pranë AZHT-së”.

2. Në pikën 1/1, togfjalëshi “dhe ai vendor” shfuqizohet.

3. Në pikën 8, togfjalëshi “dhe ai i njësisë vendore”, shfuqizohet.

4. Në pikën 9, togfjalëshi “inspektoratit përkatës të njësisë vendore dhe/apo”, shfuqizohet.

Neni 11

Në nenin 13, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, të nenit 13, togfjalëshi “trupa inspektuese e strukturës përgjegjëse për inspektimin në nivel qendror dhe/ose trupa inspektuese e inspektoratit vendor të mbrojtjes së territorit”, zëvendësohet me togfjalëshin “Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve”.

2. Në paragrafin e tretë, të shkronjës f), të pikës 2, të nenit 13, me përmbajtje “Në rastet kur dënimi merret nga trupa inspektuese e strukturës përgjegjëse për inspektimin në nivel qendror/rajonar, kjo e fundit i dërgon brenda 5 (pesë) ditëve vendimin e pezullimit inspektoratit vendor, i cili e zbaton atë brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij.”, shfuqizohet.

Neni 12

Në nenin 14, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë, ndryshohet si më poshtë:

“Kundër vendimit të trupës inspektuese të strukturës përgjegjëse për inspektimin lejohet ankimi administrativ, i cili paraqitet nga subjekti i inspektimit kundër vendimit përfundimtar të inspektimit dhe dorëzohet e shqyrtohet në Komisionin e Shqyrtimit të Ankimit pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, sipas ligji për inspektimin”.

2. Paragrafi i dytë, me përmbajtje “*Kundër vendimit të trupës inspektuese të njësisë vendore lejohet ankimi administrativ, i cili paraqitet nga subjekti i inspektimit në Komisionin e Shqyrtimit të Ankimit pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore*”, shfuqizohet.

Neni 13

Në paragrafin e parë, të pikës 1, të nenit 15, togfjalëshi “*të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore dhe të inspektorëve*”, shfuqizohet.

Neni 14

Ndryshimi i ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”

1. Në pikën 2, të nenit 7/1, togfjalëshi “*Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të bashkisë ku kryhen punimet e ndërtimit dhe autoritetin përgjegjës të planifikimit ose, sipas rastit, edhe Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve dhe autoritetin përgjegjës të planifikimit*”.

2. Në pikën 3, të nenit 7/1 dhe pikën 2, të nenit 14/3, togfjalëshi “*Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit ose, sipas rastit*”, shfuqizohet.

3. Në pikën 3, të nenit 7/2, pas togfjalëshit “*të inspektimit në nivel qendror*”, togfjalëshi “*e vendor*” shfuqizohet.

4. Në pikën 6, të nenit 8, togfjalëshi “*Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve të bashkisë ku kryhen punimet e ndërtimit ose, sipas rastit, edhe*”, shfuqizohet.

5. Në pikën 4, të nenit 10/1, pas togfjalëshi “*brenda 15 ditëve inspektoratit qendror*” togfjalëshi “*apo vendor*”, shfuqizohet.

6. Në pikën 1, të nenit 14/6, togfjalëshi “*inspektorati vendor ose kombëtar*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve*”.

7. Kudo në tekstin e këtij ligji, togfjalëshi “*struktura përgjegjëse për inspektimin në nivel vendor*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve*”, sipas kuptimit të fjalisë.

Neni 15

Ndryshimi i ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe Zhvillimin e territorit”

Në nenin 53 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“Struktura qendrore për Inspektimin – Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve, kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji në të gjithë territorin e vendit, dhe vendos sipas nenit

52 të tij, për shkeljet e konstatuara, sipas përcaktimeve të këtij ligji”

2. Pika 3, shfuqizohet.

Neni 16

Dispozita kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Strukturat vendore të mbikëqyrjes së Territorit pranë Njësive Vendore suprimohen dhe i nënshtrohen riorganizimit duke kaluar në varësi të Inspektoratit Qendror të Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve.

2. Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve, i nënshtrohet procesit të riorganizimit në zbatim të këtij ligji dhe atij “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Organika e Inspektoratit Qendror të Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve, miratohet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Deri në daljen e urdhrat për organikën, Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve do të funksionojë sipas organikes ekzistuese.

4. Me përfundimin e procesit të riorganizimit pas miratimit të organikës së Inspektoratit Qendror të Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve, praktikat dokumentare administrative/gjyqësore, të cilat janë në shqyrtim nga IMT-ët në varësi të NJVV-ve, i kalojnë për administrim e ndjekje në vazhdim të tyre Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, sipas organizimit në nivel rajonal/zyre vendore, brenda tre muajve nga miratimi i organikës.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Niko PELESHI

Miratuar në datën ____ . ____ . 2025